



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Nr. 3011/3 Prot.

Peqin, më 19/2/2024

Lënda : Shkresë përcjellëse

Drejtuar : AGJENCISE SE PROKURIMIT PUBLIK

TIRANE

Në zbatim të Ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", i ndryshuar, bashkëngjitur po ju dërgojmë në formë të shkruar dhe elektronike (CD), për botim në Buletinin e Prokurimit Publik, njoftimin e ankandit publik me objekt "Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit "Shkumbini" Sh.A në masën 80%".

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

/ Bukurosh MAÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Nr. 30/ .Prot.

Peqin, më 19/2/2024

SHTOJCA 1

NJOFTIMI I ANKANDIT

1. **Autoriteti shites:** Bashkia Peqin, Bulevardi "Mustafa Gjinishi", Peqin, e-mail "info@peqini.gov.al", faqja e internetit - www.peqini.gov.al, nr.tel. +355696697990
2. **Data e zhvillimit te ankandit:** 18.3.2024
3. **Lloji i Procedurës standarde te ankandit":** Procedurë e hapur
4. **Objekti i Shitjes:** Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit "Shkumbini" Sh.A në masën 80%;
5. **Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes:** Klubi i futbollit Shkumbini Sh.A është shoqëri e organizuar ne formen e shoqërisë aksionere e krijuar ne vitin 2011, ku aksionet zoterohen ne masen 100% nga Bashkia Peqin. Ne menyre me te zgjeruar objekti i shitjes pershkruhet ne Shtojcen 10, Specifikimet Teknike.
6. **Vlera fillestare :** Vlera fillestare me te cilen fillon ankandi publik eshte 4.000.000 (kater milion) leke
7. **Vendi i zhvillimit te ankandit:** Bashkia Peqin, Kati i Dytë, Zyra e Zv/Kryetarit te Bashkise Peqin.
8. **Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** Në zyren e Zv/Kryetarit te Bashkise Peqin, datë 18.3.2024 ora 11:00
9. **Informacion mbi dokumentet e ankandit:**
Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites
Dokumente me pagesë:

Po ☒ Jo ☐

Nëse Po

Monedha Lekë Çmimi 500

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

KRYETARI I BASHKISE

/ Bukurosh MACI /





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PEQIN

Nr. 258.Prot.

Peqin, më 07/02/2024

URDHËR

Nr. 41, datë 07.02.2024

Mbeshtetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Të kryhet procedura e ankandit publik me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Shkumbini në masën 80%”.
2. Vlera fillestare e ankandit është 4,000,000 (katërmilion) lekë.
3. Lloji i procedurës së ankandit: Procedurë e Hapur.

Arsyet e përdorimit të procedurës së mesipërme të ankandit janë;

Procedura e hapur mund të përdoret në të gjitha kontratat publike.
Procedura e hapur është procedura e preferuar në ankandin publik
Nxiti pjesëmarrjen dhe konkurrencën e ofertuesve.

4. Njësia e ankandit do të përbëhet nga;

- Francesko Rrushi Kryetar
- Gentian Cani Anëtar
- Ilda Sallufi Anëtar

Njësia e ankandit është përgjegjëse për hartimin e dokumentave të ankandit, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe për kryerjen e të gjithë veprimeve e procedurave në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e ankandit publik në fuqi.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet njësia e ankandit.

Ky urdhën hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

/ **Bukurish MACI**

